



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2021:040369

Datë: 06.11.2023

Numri i dokumentit: 04879631

C.nr.815/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA NË FUSHË KOSOVË, përmes gjyqtarit Freskim Musliu, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Makbule Maxhara nga Fushë Kosova, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av. Fitim Gashi nga Prishtina, rr. “Fehmi Agani”, Hy-25/4, ndaj të paditurës Komuna e Fushë Kosovës – Drejtoria për Shëndetësi, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Hasime Qyqalla – zyrtare ligjore tek e paditura, me objekt kontesti kompensimin e shpërblimit jubilar, jashtë seancës, me datë 06.11.2023 mori këtë:

AKTGJYKIM

I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses Magbule Maxhara nga Fushë Kosova, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Fushë Kosovës – Drejtoria për Shëndetësi, që paditëses në emër të pagës për shpërblim jubilar për 15 vitet e shërbimit t’ia paguajë shumën në vlerë të një page dhe atë prej 566.13 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga data e ushtrimit të kësaj padie e deri në pagesën definitive të borxhit, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Arsyetimi

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj, me datë 03.03.2021 ka parashtruar padi kundër të paditurës për pagesën e shpërblimit jubilar.

Në padi ka theksuar se paditësja është e punësuar tek e paditura në bazë të kontratës së punës në vendin e punës në QKMF në Fushë Kosovë dhe të njëjtës i takon shpërblimi jubilar për 15 vite të përvojës së punës, në vlerë të një page mujore prej 566.13 euro, dhe atë duke u bazuar në nenin 17, parag. 3 të Kontratës Kolektive Sektoriale në Kosovë.

Shpenzimet i ka kërkuar, por nuk i ka specifikuar.

E paditura, me datë 27.04.2023 ka parashtruar përgjigje në padi, me të cilën e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar, për arsye se paditësja vitin jubilar e ka arritur në vitin 2015, atëherë kur nuk kishte kontratë kolektive, andaj konsiderojnë se të njëjtës nuk i takon shpërblimi jubilar dhe nuk mund të përfitojë nga Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë

në Kosovë, e datës 12.06.2018. Tutje ka shtuar se duke qenë se në rastin konkret nga koha e arritjes së 10 viteve të përvojës së punës me datë 01.09.2015, deri në paraqitjen e padisë në gjykatë me datë 03.03.2021 kanë kaluar rreth 6 vite dhe një kërkesë e tillë është e parashkruar, dhe kështu kanë kërkuar nga gjykata që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës si dhe të përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) gjeti se gjendja faktike nuk është kontestuese në mes të palëve, andaj pa caktuar seancë fare, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në rastin konkret rezulton se në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësja ishte në marrëdhënie pune tek e paditura në QKMF në Fushë Kosovë. Këtë gjykata e vërtetoi nga Kontrata e punës për kohë të pacaktuar, nr. 270, e datës 06.06.2014, e lidhur në mes të paditëses dhe të paditurës.

Po ashtu, në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësja në vitin 2020 i ka pasur 15 vite përvojë pune, e që rrjedhimisht vitin jubilar prej 10 vitesh e ka arritur në vitin 2015. Ky fakt përveç se vërtetohet nga lista e pagave e muajit gusht 2020, po ashtu nuk ishte mohuar as nga e paditura.

Në mes të palëve ndërgjyqëse kontestuese ishte vetëm baza ligjore e kërkesëpadisë së paditëses.

Paditësja kërkesën e saj e bazon në Kontratën Kolektive Sektoriale të lidhur me datë 11.06.2018, dhe të nënshkruar nga Organizata e të punësuarve (Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës) si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës (Ministria e Shëndetësisë) (në vijim KKS), e cila ka qenë në fuqi nga data 11.06.2018, e deri më 10.06.2021.

Neni 399, parag. 1 i LPK-së parasheh se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*.

Andaj, nga të lartcekurat gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ashtu që e refuzoi si të pabazuar kërkesën e paditëses për shpërblim jubilar, pasi që nga gjendja faktike e vërtetuar u konstatua që paditësja vitin jubilar prej 10 vitesh e ka arritur në vitin 2015, e që në atë kohë nuk ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive Sektoriale, por e njëjta, siç thamë më lart ka hyrë në fuqi në vitin 2018. Për ta plotësuar kushtin për kompensim në emër të shpërblimit jubilar, gjykata vlerëson se duhet të plotësohen dy kushte në mënyrë komulative, kushti i parë është që viti jubilar, e në këtë rast 10 vite, të jetë arritur gjatë kohës sa ka qenë kontrata kolektive e lartcekur në fuqi, dhe kushti i dytë që përvoja e punës jubilarë të jetë tek punëdhënësi i fundit. Ndërsa siç u vërtetua më lart, paditësja vitin jubilar prej 10 vitesh e ka arritur gjatë kohës sa nuk ka qenë në fuqi KKS-ja, dhe rrjedhimisht kërkesa e paditëses për shpërblim jubilar është e pabazë ligjore. Ky interpretim është në përputhje me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 27.02.2023, me numër 40/2023.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta të procedurës, dhe atë duke u bazuar në nenin 450 të LPK-së, pasi që pala që ka pasur sukses në këtë procedurë, e në këtë rast e paditura, nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Nga se u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.815/21, datë 06.11.2023

Gjyqtari
Freskim Musliu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.